



Nga Plaku
Klaudio R. M. Kosta,
i Të Shtatëdhjetëve

Moroni dhe Mekaniku



“Dhe një fëmijë i vogël do t’i udhëheqë ata” (2 Nefi 30:12).

Shumë vite më parë, familja jonë po shkonte me makinë në shtëpi në San-Paolo, Brazil, pasi vizituum të afërmit. Pikërisht ndërsa po ngjiteshim në një rrugë të pjerrët, makina jonë u prish.

Ne u përpoqëm për disa minuta ta ndiznim përsëri makinën. Por nuk u ndez. Kaluan makinë pas makine. Asnjë nuk ndaloi të ndihmonte.

Më në fund i thashë familjes sime se duhej të luteshim. Biri im gjashtëvjeçar, Moroni, tha: “Mos u mërzit, babi. Unë u luta tashmë.”

“Për çfarë u lute?” e pyeta.

“Tu luta Atit Qiellor që personi i *duhur* të kalojë këtu pranë për të na ndihmuar”, tha ai.

Shpejt dy drita të shkëlqyera u shfaqën pas makinës sonë. Ishte një kamion rimorkiues. Shoferi ishte mekanik.

“Jeni me shumë fat”, tha ai. “Unë e mbarova punën për sot dhe po kthehesha në shtëpi.”

Ai e rregulloi makinën tonë. Pastaj na ndoqi për t’u siguruar që të shkonim të sigurt në shtëpi.

E pyeta Moronin nëse e dinte sa e veçantë ishte kjo përvojë. “Sigurisht”, u përgjigj ai. “Ati Qiellor e dëgjoi lutjen time. Prandaj tani unë kam dëshminë time! Mua nuk më duhet ta marr më hua nga ty, babi.” Zemra ime u prek nga shembulli besnik i Moronit.

Moroni është rritur tani, por unë ende e kujtoj shembullin e tij të mirë kur ai ishte i vogël. Edhe si fëmijë, ju mund të jeni shembull për familjen dhe miqtë tuaj. ■